



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri: KSC-BC-2019-02

Vendosi: Paneli i përbërë prej një gjykatësi të vetëm
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 14 mars 2019

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Version publik i redaktuar i

URDHRIT

për Administratoren për parashtrime të mëtejshme

Parashtruesi

Z. Ruzhdi Saramati

GJYKATËSI I VETËM është ngarkuar me shqyrtimin e kërkesës së parashtruar nga z. Ruzhdi Saramati ("Parashtruesi") më 23 shkurt 2019 ("Kërkesë për rishikim"),¹ për rishikimin e vendimit të Administratores në lidhje me ndihmën juridike, Ref: KSC/REG/IOR/1632, të datës 18 shkurt 2019 ("Vendim në lidhje me ndihmën juridike")² dhe në vijim urdhëron Administratoren t'i dërgojë dokumente gjykatësit të vetëm.

I. DISKUTIM

1. Gjykatësi i vetëm rikujton historikun procedural sikurse është dhënë në parashtrimet e mëparshme në lidhje me këtë çështje, i cili këtu përfshihet përmes referimit.³
2. Në veçanti, gjykatësi i vetëm rikujton se më 28 shkurt 2019, Administratorja dërgoi dokumentet përkatëse në lidhje me kërkesën për rishikim në 19 shtojca konfidenciale ("Dokumentet e dorëzuara nga Administratorja më 28 shkurt 2019").⁴ Më tej, më 6 mars 2019, Administratorja parashtrroi përgjigjen ndaj kërkesës për rishikim ("Përgjigjja e Administratores e 6 marsit 2019").⁵
3. Gjykatësi i vetëm vëren se deklarata vërtetuese që përmban Formulari i Deklarimit të Mjeteve Financiare, i cili iu dha Parashtruesit dhe u plotësua prej tij, deklararon si vijon:

Në qoftë se me kërkohet, pajtohem t'i jap pëlqim të veçantë Administratorit ose përfaqësuesit të Administratorit që të verifikojë drejtpërdrejt në institucionet financiare [...].⁶

¹ KSC-BC-2019-02, F00001, Parashtruesi, *Kërkesë për rishikimin e vendimit*, 23 shkurt 2019, publike.

² KSC-BC-2019-02, F00004, Administratorja, *Parashtrim i Administratores në bazë të urdhrit të gjykatësit të vetëm të 27 shkurtit 2019 me 19 shtojca konfidenciale*, 28 shkurt 2019, Shtojca konfidenciale 4.

³ KSC-BC-2019-02, F00007, Gjykatësi i vetëm, *Urdhër për Parashtruesin për parashtrimin e kundërpërgjigjes*, 7 mars 2019, publik, para. 1-4.

⁴ KSC-BC-2019-02, F00004, Administratorja, *Parashtrim i Administratores në bazë të urdhrit të gjykatësit të vetëm të 27 shkurtit 2019 me 19 shtojca konfidenciale*, 28 shkurt 2019.

⁵ KSC-BC-2019-02, F00006, Administratorja, *Përgjigje ndaj kërkesës për rishikim të vendimit të Administratores të 18 shkurtit 2019 në lidhje me ndihmën juridike*, konfidenciale, 6 mars 2019.

⁶ Parashtrimi i Administratores i 28 shkurtit 2019, Shtojca 2, f. 57 (theksimi i shtuar).

4. Gjykatësi i vetëm gjithashtu vëren se në vendimin e saj në lidhje me ndihmën juridike, Administratorja parashtron se “më 23 janar 2019, Zyra e Mbrojtjes i dërgoi një email [mbrojtësit të Parashtruesit] ku sqaroheshin hapat formalë për caktimin e mbrojtësit dhe ndihmën juridike.”⁷

5. Së fundi, gjykatësi i vetëm vëren parashtrimin e Administratores si vijon:

20. Zyra e Mbrojtjes e informoi Parashtruesin se duhej të dërgonte formularë të veçantë të dhënies së pëlqimit për secilën llogari bankare si edhe se çfarë informacioni duhej të përmbanin formularët e dhënies së pëlqimit për të bërë të mundur verifikimin e kërkesës për ndihmë juridike: emrin e punonjësit përgjegjës në bankë, emrin dhe numrin e telefonit të bankës, si dhe adresën elektronike (email) të personit të cilit mund t’i dërgohej Formulari i Dhënies së Pëlqimit në atë bankë.⁸

6. Në deklaratën e mësipërme, Administratorja në poshtëshënimin 18 të përgjigjes së Administratores të 6 marsit 2019, citon shtojcën konfidenciale 10 të parashtrimit të Administratores të 28 shkurtit 2019.

7. Shtojca në fjalë është një email nga Zyra e Mbrojtjes dërguar mbrojtësit të Parashtruesit, që mban datën 31 janar 2019. Në këtë email, Zyra e Mbrojtjes i dërgon Parashtruesit këtë kërkesë:

[Parashtruesi] ka dorëzuar një formular të dhënies së pëlqimit për llogarinë [e tij] bankare në [REDAKTIM], [REDAKTIM], nr. [REDAKTIM]. Megjithatë, në Formularin e Dhënies së Pëlqimit [ai] nuk ka dhënë emrin e punonjësit përgjegjës në bankë, emrin e bankës dhe të dhënat e kontaktit (telefonin dhe adresën elektronike) ku të dërgohej Formulari i Dhënies së Pëlqimit. Përveç kësaj, në të njëjtin Formular të Dhënies së Pëlqimit [ai] shënoi një llogari të dytë bankare, në [REDAKTIM], me nr. [REDAKTIM], për të cilën **duhet** të dorëzojë një formular krejt të veçantë të dhënies së pëlqimit.

Për shkak të kohës relativisht të shkurtër që ka në dispozicion Zyra e Mbrojtjes për marrjen e një vendimi të bazuar në informacion në lidhje me kërkesën [e tij] për ndihmë juridike, [Zyra e Mbrojtjes]

⁷ Parashtrimi i Administratores i 28 shkurtit 2019, Shtojca 4, f. 2.

⁸ Përgjigjja e Administratores e 6 marsit 2019, para. 20.

dëshiron t'i kërkojë [Parashtruesit] nëse mund të dorëzojë informacionin e mëposhtëm:

- a) **Gjendjen aktuale në të holla** në llogaritë e tij bankare në [REDAKTIM] dhe [REDAKTIM] dhe **kopje të deklaratave bankare** për të dyja llogaritë që prej datës 1 janar 2018 [...];
- b) Ju lutemi, deklaroni dhe na dorëzoni **deklarata bankare** që prej datës 1 janar 2018, për **çdo llogari tjetër bankare në emrin [e tij]** në të cilat merrni secilin prej [REDAKTIM] llojeve të të hyrave që keni shënuar në Formularin për Deklarimin e Mjeteve, në qoftë se ndryshojnë prej llogarive të deklaruara bankare në [REDAKTIM] dhe [REDAKTIM]. [...] ⁹

8. Bazuar në sa më sipër, nuk duket që Zyra e Mbrojtjes i ka kërkuar Parashtruesit formularë të veçantë të dhënies së pëlqimit për secilën llogari bankare.

II. KONFIDENCIALITETI

9. Duke qenë se ky Urdhër i referohet përmbajtjes së shtojcave konfidenciale të përfshira në Parashtrimin e Administratores të 28 shkurtit 2019, ai dorëzohet për protokollim si konfidencial në bazë të rregullës 82(1)(b) të Rregullores së Procedurës dhe Provave, deri në lëshimin e një versioni të redaktuar publik.

III. VENDIM

10. Bazuar në sa më sipër, gjykatësi i vetëm në vijim:

URDHËRON që, deri më 18 mars 2019, Administratorja t'i dërgojë gjykatësit të vetëm mesazhin elektronik (email) që Zyra e Mbrojtjes i ka dërguar mbrojtësit të Parashtruesit më 23 janar 2019, përfshirë edhe çfarëdo shtojcash që lidhen me të, sikurse përmendet në paragrafin 4 më sipër; dhe

⁹ Parashtrimi i Administratores i 28 shkurtit 2019, Shtojca 10, f. 8 (theksimi i shtuar).

URDHËRON që, deri më 18 mars 2019, Administratorja të sqarojë nëse i është kërkuar Parashtruesit të dorëzojë “formularë të veçantë të dhënies së pëlqimit për çdo llogari bankare”, dhe nëse po, kur i është kërkuar.

_____/nënshkrim/_____

Gjykatës Nikola Giju

Gjykatës i vetëm

E enjte, 14 mars 2019

Në Hagë, Holandë.